



KRU. "GJAKOVA" SH.A. Gjakovë			
Marrë në datën: 26.03.2025			
Njësia org.	Numri	Shtojca	Vlera
	1235		

Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT MINISTRIA E EKONOMISË MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY			
Njësia Org.	0113	Nr. Prof.	1547
Org. Jedin		Br. Prof.	
Org Unit		Prof.No:	
Nr. i faqeve	1	Data:	27.03.25
Broj stranica		Datum:	
No. pages		Date:	
PRISHTINË/A		NO.1	

RAPORT

Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet e ofruara nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. për vitin 2024

Shkurt 2025



TITULLI I PROJEKTIT:

“Hulumtimi i kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet e ofruara nga
K.R.U “Gjakova” Sh.A., për vitin 2024”

OPERATORI EKONOMIK:



D&D BUSINESS SUPPORT CENTER

Rr. "Xheladin Hana", Ndërtesa Iliria,
10000 Prishtina, Republika e Kosovës
Tel.: +383 (0) 38 748 701, +383 (0) 44 693 564
E-mail: info@dd-bsc.com
Web: www.dd-bsc.com

AUTORITETI KONTRAKTUES:



Kompania Rajonale e Ujësjellësit
Regional Water Supply Company
Regionalna vodovodna kompanija

K.R.U. “Gjakova” SH.A

Rruga e UÇK-së Gjakovë
50000 Gjakovë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 390 310 201
Web: info@kru-gjakova.com

Përmbajtja

1.	HYRJE	9
2.	METODOLOGJIA	10
3.	TË DHËNAT DEMOGRAFIKE	11
3.1.	Vendbanimi	11
3.2.	Mosha	12
3.3.	Gjinia	13
3.4.	Tipi i vendbanimit	14
4.	TË GJETURAT NGA HULUMTIMI	15
4.1.	Lloji i konsumatorit	15
4.2.	Rezultatet nga pyetësi.....	16
4.3.	Vlerësimi i tarifave të shërbimeve nga konsumatorët	17
4.4.	Ujëmatësi.....	18
4.5.	Leximi i ujëmatësit.....	19
4.6.	Rregullsia e pagesës së faturave nga konsumatorët.....	20
4.7.	Arsyet që ndikojnë në vonesën e pagesave	21
4.8.	Procedura e përmbimit në rast të mos pagesës	22
4.9.	Njohuritë mbi mundësinë e pagesës së borxhit me këste mujore.....	23
4.10.	Paraqitja e Ankesave nga Konsumatorët	24
4.11.	Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave	25
4.12.	Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjimit të defekteve	26
4.13.	Kontrata e shërbimit me kompaninë	27
4.14.	Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	28
4.15.	Ndikimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në shëndetin publik dhe mbrojtjen e ujërave	29
4.16.	Njohuria mbi ekzistencën e web-faqes zyrtare	30
4.17.	Kënaqësia e Konsumatorëve me Publikimin e Informacioneve në Web-Faqe dhe Rjete Sociale.....	31
4.18.	Njohuria për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).....	32
4.19.	Komentet e konsumatorëve mbi shërbimet e ofruara nga K.R.U. Gjakova Sh.A.	33
5.	SEKTORI I AMVISËRISË	34
5.1.	Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e amvisërisë.....	34
5.2.	Vlerësimi i tarifave të shërbimeve nga konsumatorët në sektorin e amvisërisë	35
5.3.	Ujëmatësi në sektorin e amvisërisë	36

5.4.	Leximi i ujëmatësit në sektorin e amvisërisë.....	37
5.5.	Rregullsia e pagesës së faturave nga konsumatorët në sektorin e amvisërisë	38
5.6.	Arsyet që ndikojnë në vonesën e pagesave në sektorin e amvisërisë.....	39
5.7.	Procedura e përmbarimit në rastet e mos pagesës nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë.....	40
5.8.	Njohuritë mbi mundësinë e pagesës së borxhit me këste mujore në sektorin e amvisërisë 41	
5.9.	Paraqitja e ankesave nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë.....	42
5.10.	Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	43
5.11.	Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimin të defekteve në sektorin e amvisërisë.....	44
5.12.	Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e amvisërisë.....	45
5.13.	Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	46
5.14.	Njohuria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë mbi trajtimin e ujërave të ndotura dhe ndikimin e tij në shëndetin publik	47
5.15.	Njohuria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë mbi ekzistencën e web-faqes zyrtare 48	
5.16.	Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale	49
5.17.	Informimi për Autoritetin Rregullator për shërbimet e ujit në sektorin e amvisërisë.....	50
6.	SEKTORI I BIZNESEVE DHE INSTITUCIONEVE	51
6.1.	Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e bizneseve/institucioneve	51
6.2.	Vlerësimi i tarifave të shërbimeve nga konsumatorët në sektorin e bizneseve/institucioneve	52
6.3.	Ujëmatësi në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	53
6.4.	Leximi i ujëmatësit në sektorin e bizneseve/institucioneve	54
6.5.	Rregullsia e pagesës së faturave nga konsumatorët në sektorin e bizneseve/institucioneve	55
6.6.	Arsyet që ndikojnë në vonesën e pagesave në sektorin e bizneseve/institucioneve ...	56
6.7.	Procedura e përmbarimit në rastet e mospagesës nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve	57
6.8.	Njohuritë mbi mundësinë e pagesës së borxhit me këste mujore në sektorin e bizneseve/institucioneve	58
6.9.	Paraqitja e ankesave nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve	59
6.10.	Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	60

6.11. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e menjanimit të defekteve në sektorin e bizneseve/institucioneve	61
6.12. Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e bizneseve/institucioneve	62
6.13. Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	63
6.14. Njohuria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve mbi trajtimin e ujërave të ndotura dhe ndikimin e tij në shëndetin publik	64
6.15. Njohuria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve mbi ekzistencën e web-faqes zyrtare	65
6.16. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale	66
6.17. Informimi për Autoritetin Rregullator për shërbimet e ujit në sektorin e bizneseve/institucioneve	67
7. REKOMANDIME DHE KONKULZIONE	68
8. Annex 1. Pyetësori.....	69

Lista e Tabelave

Tabela 1. Vendbanimi	11
Tabela 2. Moshë	12
Tabela 3. Gjinia	13
Tabela 4. Tipi i vendbanimit	14
Tabela 5. Lloji i konsumatorit	15
Tabela 6. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara	16
Tabela 7. Vlerësimi i Tarifave nga Konsumatorët.....	17
Tabela 8. Ujëmatësi.....	18
Tabela 9. Rregullsia e leximit të ujëmatësit.....	19
Tabela 10. Rregullsia e pagesës së faturave.....	20
Tabela 11. Arsyet për mospagesë	21
Tabela 12. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës	22
Tabela 13. Mundësia e pagesës së borxhit me këste mujore.....	23
Tabela 14. Ankesat e konsumatorëve.....	24
Tabela 15. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave	25
Tabela 16. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e menjanimit të defekteve.....	26
Tabela 17. Kontrata e shërbimit me kompaninë	27
Tabela 18. Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.....	28
Tabela 19. Informimi mbi ndikimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura	29
Tabela 20. Informimi i konsumatorëve për web-faqen.....	30
Tabela 21. Vlerësimi i konsumatorëve për publikimin e informacioneve online	31
Tabela 22. Niveli i njohurisë për autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (ARRU).....	32
Tabela 23. Komentet për përmirësimin e shërbimeve.....	33
Tabela 24. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara në sektorin e amvisërisë	34

Tabela 25. Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e amvisërisë	35
Tabela 26. Ujëmatësi në sektorin e amvisërisë.....	36
Tabela 27. Leximi i ujëmatësit në sektorin e amvisërisë	37
Tabela 28. Rregullsia e pagesës së faturave në sektorin e amvisërisë.....	38
Tabela 29. Arsyet për mospagesë në sektorin e amvisërisë.....	39
Tabela 30. Procedurat e përmbartimit në rastet e mospagesës nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë	40
Tabela 31. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës në sektorin e amvisërisë.....	41
Tabela 32. Ankesat nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë.....	42
Tabela 33. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave	43
Tabela 34. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e menjanimin të defekteve në sektorin e amvisërisë.....	44
Tabela 35. Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e amvisërisë.....	45
Tabela 36. Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.....	46
Tabela 37. Trajtimi i ujërave të ndotura në sektorin e amvisërisë.....	47
Tabela 38. Informimi i konsumatorëve të sektorit të amvisërisë për web-faqen	48
Tabela 39. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale.....	49
Tabela 40. Informimi për autoritetin Rregullator për shërbimet e ujit në sektorin e amvisërisë.....	50
Tabela 41. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	51
Tabela 42. Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	52
Tabela 43. Ujëmatësi në sektorin e bizneseve/institucioneve	53
Tabela 44. Leximi i ujëmatësit në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	54
Tabela 45. Rregullsia e pagesës së faturave në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	55
Tabela 46. Arsyet për mospagesë në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	56
Tabela 47. Procedura e përmbartimit në rastet e mospagesës nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve	57
Tabela 48. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës në sektorin e bizneseve/institucioneve	58
Tabela 49. Ankesat nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve.....	59
Tabela 50. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	60
Tabela 51. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e menjanimin të defekteve në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	61
Tabela 52. Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	62
Tabela 53. Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	63
Tabela 54. Trajtimi i ujërave të ndotura në sektorin e bizneseve/institucioneve	64
Tabela 55. Informimi i konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve për web-faqen.....	65
Tabela 56. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale.....	66
Tabela 57. Informimi për autoritetin Rregullator për shërbimet e ujit në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	67

Lista e Figurave

Figura 1. Vendbanimi.....	11
Figura 2. Moshë.....	12
Figura 3. Gjinia.....	13
Figura 4. Tipi i vendbanimit.....	14
Figura 5. Lloji i konsumatorit.....	15
Figura 6. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara.....	16
Figura 7. Vlerësimi i Tarifave nga Konsumatorët.....	17
Figura 8. Ujëmatësi.....	18
Figura 9. Rregullsia e leximit të ujëmatësit.....	19
Figura 10. Rregullsia e pagesës së faturave.....	20
Figura 11. Arsyet për mospagesë.....	21
Figura 12. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës.....	22
Figura 13. Mundësia e pagesës së borxhit me këste mujore.....	23
Figura 14. Ankesat e konsumatorëve.....	24
Figura 15. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	25
Figura 16. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimin të defekteve.....	26
Figura 17. Kontrata e shërbimit me kompaninë.....	27
Figura 18. Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.....	28
Figura 19. Informimi mbi ndikimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.....	29
Figura 20. Informimi i konsumatorëve për web-faqen.....	30
Figura 21. Vlerësimi i konsumatorëve për publikimin e informacioneve online.....	31
Figura 22. Niveli i njohurisë për autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (ARRU).....	32
Figura 23. Komentet për përmirësimin e shërbimeve.....	33
Figura 24. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara në sektorin e amvisërisë.....	34
Figura 25. Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e amvisërisë.....	35
Figura 26. Ujëmatësi në sektorin e amvisërisë.....	36
Figura 27. Leximi i ujëmatësit në sektorin e amvisërisë.....	37
Figura 28. Rregullsia e pagesës së faturave në sektorin e amvisërisë.....	38
Figura 29. Arsyet për mospagesë në sektorin e amvisërisë.....	39
Figura 30. Procedurat e përmbartimit në rastet e mospagesës nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë.....	40
Figura 31. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës në sektorin e amvisërisë.....	41
Figura 32. Ankesat nga konsumatorët e sektorit të amvisërisë.....	42
Figura 33. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	43
Figura 34. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimin të defekteve në sektorin e amvisërisë.....	44
Figura 35. Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e amvisërisë.....	45
Figura 36. Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura.....	46
Figura 37. Trajtimi i ujërave të ndotura në sektorin e amvisërisë.....	47
Figura 38. Informimi i konsumatorëve të sektorit të amvisërisë për web-faqen.....	48
Figura 39. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të amvisërisë me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale.....	49

Figura 40. Informimi për autoritetin Rrregullator për shërbimet e ujit në sektorin e amvisërisë	50
Figura 41. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara në sektorin e bizneseve/institucioneve	51
Figura 42. Vlerësimi i tarifave nga konsumatorët në sektorin e bizneseve/institucioneve	52
Figura 43. Ujëmatësi në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	53
Figura 44. Leximi i ujëmatësit në sektorin e bizneseve/institucioneve	54
Figura 45. Rregullsia e pagesës së faturave në sektorin e bizneseve/institucioneve	55
Figura 46. Arsyet për mospagesë në sektorin e bizneseve/institucioneve	56
Figura 47. Procedura e përmbartimit në rastet e mospagesës nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve	57
Figura 48. Procedura e përmbartimit në rast të mospagesës në sektorin e bizneseve/institucioneve	58
Figura 49. Ankesat nga konsumatorët e sektorit të bizneseve/institucioneve	59
Figura 50. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave.....	60
Figura 51. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e menjimit të defekteve në sektorin e bizneseve/institucioneve	61
Figura 52. Kontrata e shërbimit me kompaninë në sektorin e bizneseve/institucioneve	62
Figura 53. Njohuritë e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura	63
Figura 54. Trajtimi i ujërave të ndotura në sektorin e bizneseve/institucioneve.....	64
Figura 55. Informimi i konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve për web-faqen.....	65
Figura 56. Kënaqshmëria e konsumatorëve të sektorit të bizneseve/institucioneve me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale.....	66
Figura 57. Informimi për autoritetin Rrregullator për shërbimet e ujit në sektorin e bizneseve/institucioneve	67

1. HYRJE

Sigurimi i ujit të pijshëm cilësor dhe menaxhimi efikas i kanalizimeve janë elementë thelbësorë për mirëqenien e komunitetit. Kompania Rajonale e Ujësjellësit Gjakova Sh.A, është e angazhuar në ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe të besueshme për konsumatorët e saj, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve më efikase dhe rritjen e cilësisë së tyre.

Për të kuptuar më mirë nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve, si dhe për të vlerësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara, gjatë vitit 2024 është realizuar një hulumtim i dedikuar mbi kënaqshmërinë e konsumatorëve. Ky studim përfshin konsumatorët nga zonat që mbulon K.R.U. Gjakova Sh.A., konkretisht:

- Gjakovë;
- Rahovec;
- Lumbardh.

Ky hulumtim është realizuar nga kompania konsulente D&D Business Support Center dhe financuar nga K.R.U. Gjakova Sh.A., që ka për synim të analizojë perceptimin e qytetarëve ndaj shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2024. Përmes rezultateve të përfuara, synohet identifikimi i aspekteve që kanë nevojë për përmirësim, si dhe adresimi i sfidave që ndikojnë në kënaqësinë e konsumatorëve.

Raporti është i strukturuar në tri pjesë kryesore:

- Metodologjia dhe qëllimi i hulumtimit;
- Analiza e rezultateve dhe vlerësimi i të dhënave të mbledhura;
- Rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Rezultatet e këtij studimi do të ndihmojnë K.R.U. Gjakova Sh.A. të marrë masa konkrete për të rritur efikasitetin dhe për të përmirësuar përvojën e konsumatorëve me shërbimet e ofruara.

- Kënaqësisë së përgjithshme me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, përfshirë efikasitetin në zgjidhjen e ankesave dhe defekteve;
- Perceptimit të konsumatorëve mbi tarifën e shërbimeve dhe rregullsinë e pagesave;
- Përdorimit të ujëmatësve, rregullsisë së leximit të tyre dhe ndikimit në faturim;
- Ndërgjegjësimin e konsumatorëve mbi pasojat e mospagesës, përfshirë mundësinë e inicimit të lëndës tek përmbartuesi privat dhe opsionin e pagesës me këste;
- Nivelit të informimit mbi impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe rëndësinë e tij për shëndetin publik dhe mbrojtjen e mjedisit

- Nivelit të informimit të konsumatorëve mbi shërbimet dhe aktivitetet e kompanisë përmes web-faqes dhe rrjeteve sociale;
- Njohurive mbi Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) dhe rolin e tij;

2. METODOLOGJIA

Hulumtimi është realizuar me qëllim matjen e nivelit të kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A., si dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim.

Përmes këtij hulumtimi synohet të ofrohet një pasqyrë e qartë mbi përvojën e konsumatorëve, duke analizuar sfidat kryesore dhe pritshmëritë e tyre, me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së tyre nga K.R.U. 'Gjakova' Sh.A.

Për mbledhjen e të dhënave është hartuar një pyetësor i strukturuar, i cili ka mundësuar grumbullimin e informatave statistikore dhe opinioneve të konsumatorëve. Anketimi është zhvilluar përmes disa metodave: me prezencë fizike në terren në zonat që mbulon K.R.U. "Gjakova" Sh.A. dhe elektronikisht (përmes Google Forms), dhe rrjeteve sociale (online).

Në këtë hulumtim janë përfshirë gjithsej 2,448 respondentë, duke siguruar një përfaqësim gjithëpërfshirës nga aspekti gjeografik, demografik dhe sektorial. Pyetësori është dizajnuar për të mbuluar një gamë të gjerë faktorësh që ndikojnë në përvojën e konsumatorëve me shërbimet e kompanisë.

Pyetësori është i ndarë në dy pjesë kryesore:

- **Pjesa e parë** – Përmban informata demografike bazë si vendbanimi, gjinia, mosha, lloji i vendbanimit dhe sektori përkatës (amvisëri, biznes ose institucion).
- **Pjesa e dytë** – Përqendrohet në matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve me furnizimin me ujë të pijshëm, efikasitetin në trajtimin e ankesave dhe kërkesave, sistemin e faturimit, procesin e leximit të ujëmatësve dhe nivelin e informimit mbi impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura dhe Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

3. TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

3.1. Vendbanimi

Në kuadër të këtij hulumtimi janë realizuar gjithsej 2,488 anketa në zonat që mbulon K.R.U. Gjakova Sh.A. Të dhënat më të detajuara mbi shpërndarjen e të anketuarve sipas vendbanimit të tyre janë paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Nga numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve, në komunën e Gjakovës janë anketuar 1,770 qytetarë, që përfaqësojnë shumicën e të anketuarve. Në Rahovec, janë realizuar 383 anketa, ndërsa në fshatin Lumbardh kemi 335 të anketuar.

Tabela 1. Vendbanimi

Vendbanimi	Totali	Përqindja
Gjakovë	1770	71.14%
Rahovec	383	15.39%
Lumbardh	335	13.46%
Total	2,488	100.00%




Figura 1. Vendbanimi

3.2. Mosha

Më poshtë janë paraqitura të dhënat lidhur me përfaqësimin e grupmoshave të të anketuarve. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të shpërndarjes së tyre sipas kategorive përkatëse, duke reflektuar diversitetin e pjesëmarrësve në këtë anketë.

Tabela 2. Moshë

Moshë	Totali	Përqindja
18-24	355	14.27%
25-34	823	33.08%
35-54	1,104	44.37%
54+	206	8.28%
TOTAL	2,488	100.00%




Figura 2. Moshë

3.3. Gjinia

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 2,488 të anketuar. Sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë, nga numri i përgjithshëm, 881 janë femra, ndërsa 1,607 janë meshkuj. Të dhënat më të detajuara mbi shpërndarjen gjinore të të anketuarve janë paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 3. Gjinia

Gjinia	Totali	Përqindja
Femër	881	35.41%
Mashkull	1607	64.59%
Total	2,488	100.00%




Figura 3. Gjinia

3.4. Tipi i vendbanimit

Në këtë hulumtim janë përfshirë gjithsej 2,488 të anketuar, të cilët vijnë nga zona të ndryshme banimi. Nga ky numër, 1,559 anketime janë realizuar në zonat urbane, ndërsa 929 në zonat rurale. Shpërndarja e detajuar e të dhënave sipas tipit të vendbanimit është paraqitur në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm.

Tabela 4. Tipi i vendbanimit

Tipi i vendbanimit	Totali	Përqindja
Fshat	929	37.34%
Qytet	1,559	62.66%
Total	2,488	100.00%




Figura 4. Tipi i vendbanimit

4. TË GJETURAT NGA HULUMTIMI

4.1. Lloji i konsumatorit

Në këtë hulumtim janë përfshirë konsumatorë nga dy kategori kryesore: amvisëritë dhe bizneset/institucionet, duke siguruar një përfaqësim të gjerë të grupeve të ndryshme të shfrytëzuesve të shërbimeve të K.R.U. "Gjakova" Sh.A.

Tabela 5. Lloji i konsumatorit

Qytet	Amviseri	Biznese/Institucione	Totali
Gjakovë	1595	175	1770
	90.11%	9.89%	100.00%
Rahovec	335	48	383
	87.47%	12.53%	100.00%
Lumbardh	290	45	335
	86.57%	13.43%	100.00%
Total	2220	268	2488
	89.23%	10.77%	100.00%

Nga numri total i të anketuarve, shumica përfaqësojnë sektorin e amvisërive, ku 1,595 anketime janë realizuar në komunën e Gjakovës, 335 në Rahovec dhe 290 në Lumbardh. Ndërkohë, sektori i bizneseve dhe institucioneve përbëhet nga 175 të anketuar në Gjakovë, 48 në Rahovec dhe 45 në Lumbardh. Shpërndarja e detajuar e këtyre të dhënave mund të shihet në tabelën e mësipërme dhe grafikun e mëposhtëm.




Figura 5. Lloji i konsumatorit

4.2. Rezultatet nga pyetësi

Tabela 6. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara

Qytet	Shumë të kënaqur	Mesatarisht të kënaqur	Të pakënaqur	Totali
Gjakovë	1501	225	44	1770
	84.80%	12.71%	2.49%	71.14%
Rahovec	163	210	10	383
	42.56%	54.83%	2.61%	15.39%
Lumbardh	215	109	11	335
	64.18%	32.54%	3.28%	13.46%
Total	1879	544	65	2488
	75.52%	21.86%	2.61%	100.00%

Në bazë të rezultateve të hulumtimit, shumica dërrmuese e të anketuarve, 1,879 persona ose 75.52%, kanë deklaruar se janë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Ndërkohë, 544 të anketuar, që përbëjnë 21.86%, kanë shprehur një kënaqësi mesatare, duke treguar se ka ende hapësirë për përmirësim në disa aspekte të shërbimeve. Një përqindje e vogël, 65 persona ose 2.61%, janë shprehur të pakënaqur, duke reflektuar sfidat ose problematikat që mund të ekzistojnë në shërbimet.




Figura 6. Niveli i kënaqësisë me shërbimet e ofruara

4.3. Vlerësimi i tarifave të shërbimeve nga konsumatorët

Tabela 7. Vlerësimi i Tarifave nga Konsumatorët

Qytet	Të larta	Të përballueshme	Të ulëta	Totali
Gjakovë	190	1018	562	1770
	10.73%	57.51%	31.75%	71.14%
Rahovec	24	266	93	383
	6.27%	69.45%	24.28%	15.39%
Lumbardh	22	295	18	335
	6.57%	88.06%	5.37%	13.46%
Total	236	1579	673	2488
	9.49%	63.46%	27.05%	100.00%

Në lidhje me vlerësimin e tarifave të shërbimeve, shumica e të anketuarve, konkretisht 1,579 ose 63.46%, i konsiderojnë ato si të përballueshme, duke treguar një perceptim pozitiv në lidhje me kostot e shërbimeve të ofruara nga K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Një pjesë e vogël, 236 apo 9.49%, i shohin tarifën si të larta, ndërkohë 673 ose 27.05% i vlerësojnë tarifën si të ulëta, duke treguar se për ta, kostot e shërbimeve janë të arsyeshme.




Figura 7. Vlerësimi i Tarifave nga Konsumatorët

4.4. Ujëmatësi

Tabela 8. Ujëmatësi.

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1770	0	1770
Rahovec	383	0	383
Lumbardh	335	0	335
Total	2488	0	2488

Të gjithë të anketuarit kanë pohuar se posedojnë ujëmatës, duke treguar se sistemi i matjes së konsumit është i përhapur dhe i përdorur gjerësisht nga konsumatorët e K.R.U. "Gjakova" Sh.A.




Figura 8. Ujëmatësi

4.5. Leximi i ujëmatësit

Të dhënat e paraqitura në këtë pjesë të raportit pasqyrojnë perceptimin e konsumatorëve lidhur me rregullsinë e leximit të ujëmatësve.

Tabela 9. Rregullsia e leximit të ujëmatësit

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1586 89.60%	184 10.40%	1770 71.14%
Rahovec	353 92.17%	30 7.83%	383 15.39%
Lumbardh	312 93.13%	23 6.87%	335 13.46%
Total	2251 90.47%	237 9.53%	2488 100.00%

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se shumica dërrmuese e të anketuarve, konkretisht 2251 persona të anketuar (90.47%), kanë konfirmuar se ujëmatësi u lexohet në mënyrë të rregullt, duke treguar një nivel të kënaqshëm të menaxhimit të këtij procesi. Ndërkohë, 237 apo (9.53%) kanë deklaruar se nuk u lexohet në mënyrë të rregullt.




Figura 9. Rregullsia e leximit të ujëmatësit

4.6. Rregullsia e pagesës së faturave nga konsumatorët

Tabela 10. Rregullsia e pagesës së faturave

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1568 88.59%	202 11.41%	1770 71.14%
Rahovec	346 90.34%	37 9.66%	383 15.39%
Lumbardh	313 93.43%	22 6.57%	335 13.46%
Total	2227 89.51%	261 10.49%	2488 100.00%

Në lidhje me pagesën e faturave, shumica dërrmuese e të anketuarve, konkretisht 2,227 persona (89.51%), kanë deklaruar se i paguajnë faturat në mënyrë të rregullt, duke treguar një nivel të lartë të përgjegjësisë financiare ndaj shërbimeve të ofruara. Nga ana tjetër, një grup më i vogël prej 261 personash (10.49%) kanë pohuar se nuk i kryejnë pagesat në kohën e duhur.




Figura 10. Rregullsia e pagesës së faturave

4.7. Arsyet që ndikojnë në vonesën e pagesave

Tabela 11: Arsyet për mospagesë

Arsyet për mospagesë?	Gjendja Sociale	I/e pakënaqur me nivelin e shërbimit	Pakënaqësi me lexuesin	Totali
Gjakovë	182 90.10%	14 6.93%	6 2.97%	202 77.39%
Rahovec	25 67.57%	10 27.03%	2 5.41%	37 14.18%
Lumbardh	17 77.27%	3 13.64%	2 9.09%	22 8.43%
Total	224 85.82%	27 10.34%	10 3.83%	261 100.00%

Sa i përket arsyeve të mos pagesës së faturave, një përqindje e madhe e të anketuarve që nuk i kryejnë pagesat në kohën e duhur e lidhin këtë me gjendjen e tyre socio-ekonomike, duke përfaqësuar 224 të anketuar (85.82%) të përgjigjeve. Nga ana tjetër, 27 të anketuar (10.34%), ka shprehur pakënaqësi me nivelin e shërbimit si arsye kryesore për mospagesën e faturave. Për detaje të mëtejshme mbi shpërndarjen e përgjigjeve sipas kategorive, referojuni tabelës dhe grafikut të mëposhtëm.




Figura 11. Arsyet për mospagesë

4.8. Procedura e përmbarimit në rast të mos pagesës

Tabela 12. Procedura e përmbarimit në rast të mospagesës

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1670 94.35%	100 5.65%	1770 71.14%
Rahovec	360 93.99%	23 6.01%	383 15.39%
Lumbardh	284 84.78%	51 15.22%	335 13.46%
Total	2314 93.01%	174 6.99%	2488 100.00%

Në këtë hulumtim është shqyrtuar niveli i informimit të konsumatorëve lidhur me procedurat që pasojnë në rast të mospagesës së borxhit. Nga totali prej 2,488 të anketuarve, rezulton se 2,314 (93.01%) janë të vetëdijshëm se lënda e tyre mund të referohet përmbaruesit privat në rast të mosshlyerjes së detyrimeve financiare. Ndërkohë, 174 apo (6.99%) e të anketuarve nuk kanë qenë të informuar për këtë procedurë.




Figura 12. Procedura e përmbarimit në rast të mospagesës

4.9. Njohuritë mbi mundësinë e pagesës së borxhit me këste mujore

Tabela 13: Mundësia e pagesës së borxhit me këste mujore

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1583 89.44%	187 10.56%	1770 71.14%
Rahovec	351 91.64%	32 8.36%	383 15.39%
Lumbardh	191 57.01%	144 42.99%	335 13.46%
Total	2125 85.41%	363 14.59%	2488 100.00%

Të anketuarit janë pyetur nëse janë të informuar për mundësinë e nënshkrimit të një kontrate me këste mujore për pagesën e borxhit në rast se ai është i lartë. Nga përgjigjet e marra, një shumicë dërrmuese prej 2,125 të anketuarve (85.41%) kanë pohuar se janë në dijeni për këtë mundësi, duke treguar një nivel të lartë informimi mbi opsionet e pagesës së borxhit. Ndërkohë, 363 të anketuar (14.59%) kanë deklaruar se nuk kanë njohuri për këtë të drejtë, gjë që sugjeron nevojën për përmirësimin e informimit të konsumatorëve mbi alternativat që ata kanë në rast të borxheve të papaguara.




Figura 13. Mundësia e pagesës së borxhit me këste mujore

4.10. Paraqitja e Ankesave nga Konsumatorët

Tabela 14. Ankesat e konsumatorëve

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	430 24.29%	1340 75.71%	1770 71.14%
Rahovec	161 42.04%	222 57.96%	383 15.39%
Lumbardh	181 54.03%	154 45.97%	335 13.46%
Total	772 31.03%	1716 68.97%	2488 100.00%

Të gjeturat e hulumtimit mbi këtë pyetje tregojnë se 1,716 persona (68.97%) nuk kanë pasur asnjëherë nevojë të bëjnë një ankesë lidhur me shërbimet e marra. Kjo tregon një nivel të lartë kënaqësie me shërbimet ose një mungesë të iniciativës për të raportuar çështje të mundshme. Nga ana tjetër, 772 persona të anketur (31.03%) kanë deklaruar se kanë paraqitur ankesa, duke reflektuar përvoja të ndryshme në lidhje me cilësinë dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara.




Figura 14. Ankesat e konsumatorëve

4.11. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave

Tabela 15. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave

Qytet	Shumë të kënaqur	Mesatarisht të kënaqur	Aspak të kënaqur	Totali
Gjakovë	1359	347	64	1770
	76.78%	19.60%	3.62%	71.14%
Rahovec	329	37	17	383
	85.90%	9.66%	4.44%	15.39%
Lumbardh	276	40	19	335
	82.39%	11.94%	5.67%	13.46%
Total	1964	424	100	2488
	78.94%	17.04%	4.02%	100.00%

Sa i përket kënaqshmërisë së konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave, të dhënat tregojnë se një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve, konkretisht 1,964 persona (78.94%), janë shprehur shumë të kënaqur me këtë proces. Një tjetër grup prej 424 të anketuarish (17.04%) ka raportuar një kënaqësi mesatare, ndërsa vetëm 100 persona (4.02%) kanë shprehur pakënaqësi në lidhje me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave.




Figura 15. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e zgjidhjes së ankesave/kërkesave

4.12. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimit të defekteve

Tabela 16. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimit të defekteve

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1652	118	1770
	93.33%	6.67%	71.14%
Rahovec	358	25	383
	93.47%	6.53%	15.39%
Lumbardh	259	76	335
	77.31%	22.69%	13.46%
Total	2269	219	2488
	91.20%	8.80%	100.00%

Sa i përket kënaqshmërisë së konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimit të defekteve, të dhënat tregojnë një nivel të lartë kënaqësie nga ana e të anketuarve. Konkretisht, 2,269 persona të anketuar (91.20%) kanë shprehur kënaqësi me mënyrën se si menaxhohen defektet, ndërsa vetëm 219 (8.80%) prej tyre kanë shprehur pakënaqësi në lidhje me këtë aspekt.




Figura 16. Kënaqshmëria e konsumatorëve lidhur me efikasitetin e mënjanimit të defekteve

4.13. Kontrata e shërbimit me kompaninë

Tabela 17. Kontrata e shërbimit me kompaninë

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1770 100.00%	0 0.00%	1770 71.14%
Rahovec	383 100.00%	0 0.00%	383 15.39%
Lumbardh	335 100.00%	0 0.00%	335 13.46%
Total	2488 100.00%	0 0.00%	2488 100.00%

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se të gjithë 2,488 të anketuarit kanë një kontratë aktive shërbimi me kompaninë, duke e çuar këtë tregues në 100%. Ky fakt dëshmon se të gjithë pjesëmarrësit në anketë janë konsumatorë të rregullt dhe të regjistruar, të cilët marrin shërbime nga kjo kompani.




Figura 17. Kontrata e shërbimit me kompaninë

4.14. Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

Tabela 18. Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1231 69.55%	539 30.45%	1770 71.14%
Rahovec	305 79.63%	78 20.37%	383 15.39%
Lumbardh	146 43.58%	189 56.42%	335 13.46%
Total	1682 67.60%	806 32.40%	2488 100.00%

Nga 2,488 të anketuarit, 1,682 persona (67.60%) kanë deklaruar se janë të informuar për ekzistencën dhe funksionin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, duke treguar një nivel relativisht të lartë të vetëdijes publike mbi këtë infrastrukturë. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme (32.40%) ende nuk ka njohuri mbi këtë impiant.




Figura 18. Njohuritë e konsumatorëve për impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura

4.15. Ndikimi i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në shëndetin publik dhe mbrojtjen e ujërave

Tabela 19. Informimi mbi ndikimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1418	352	1770
	80.11%	19.89%	71.14%
Rahovec	291	92	383
	75.98%	24.02%	15.39%
Lumbardh	133	202	335
	39.70%	60.30%	13.46%
Total	1842	646	2488
	74.04%	25.96%	100.00%

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se 1842 apo (74.04%) e të anketuarve janë të vetëdijshëm për ndikimin pozitiv të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në mbrojtjen e shëndetit publik dhe parandalimin e degradimit të trupave ujqorë. Ndërkohë, 646 të anketuar, (25.96%), nuk kanë njohuri mbi këtë çështje, duke treguar nevojën për informim dhe ndërgjegjësim të mëtejshëm mbi rëndësinë e këtij procesi.




Figura 19. Informimi mbi ndikimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura

4.16. Njohuria mbi ekzistencën e web-faqes zyrtare

Tabela 20: Informimi i konsumatorëve për web-faqen.

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1583 89.44%	187 10.56%	1770 71.14%
Rahovec	353 92.17%	30 7.83%	383 15.39%
Lumbardh	309 92.24%	26 7.76%	335 13.46%
Total	2245 90.23%	243 9.77%	2488 100.00%

Të dhënat tregojnë se nga gjithsej 2,488 të anketuar, 2,245 persona (90.23%) janë të informuar për ekzistencën e web-faqes, duke reflektuar një nivel të lartë të ndërgjegjësimit mbi këtë kanal informimi. Ndërkohë, 243 persona (9.77%) nuk janë të informuar mbi këtë platformë.




Figura 20. Informimi i konsumatorëve për web-faqen

4.17. Kënaqësia e Konsumatorëve me Publikimin e Informacioneve në Web-Faqe dhe Rrjete Sociale

Tabela 21. Vlerësimi i konsumatorëve për publikimin e informacioneve online

Qytet	Shumë të kënaqur	Mesatarisht të kënaqur	Aspak të kënaqur	Totali
Gjakovë	1384 78.19%	359 20.28%	27 1.53%	1770 71.14%
Rahovec	150 39.16%	219 57.18%	14 3.66%	383 15.39%
Lumbardh	112 33.43%	212 63.28%	11 3.28%	335 13.46%
Total	1646 66.16%	790 31.75%	52 2.09%	2488 100.00%

Nga gjithsej 2,488 të anketuar, 1,646 persona (66.16%) janë shprehur se janë shumë të kënaqur me publikimin e informacioneve në web-faqe dhe rrjete sociale të K.R.U. "Gjakova" Sh.A. Ndërkohë, 790 persona (31.75%) kanë vlerësuar nivelin e informimit si mesatarisht të kënaqshëm, ndërsa 52 persona (2.09%) kanë shprehur pakënaqësitë e tyre.




Figura 21. Vlerësimi i konsumatorëve për publikimin e informacioneve online

4.18. Njohuria për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU)

Tabela 22: Niveli i njohurisë për autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (ARRU)

Qytet	Po	Jo	Totali
Gjakovë	1345 75.99%	425 24.01%	1770 71.14%
Rahovec	332 86.68%	51 13.32%	383 15.39%
Lumbardh	117 34.93%	218 65.07%	335 13.46%
Total	1794 72.11%	694 27.89%	2488 100.00%

Nga gjithsej 2,488 të anketuar, 1,794 persona (72.11%) kanë deklaruar se kanë njohuri për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), ndërsa 694 persona (27.89%) nuk janë të informuar plotësisht për këtë institucion. Këto rezultate tregojnë një nivel të mirë të ndërgjegjësimit publik mbi rolin e ARRU-së, me hapësirë për informim edhe më të gjerë.




Figura 22. Niveli i njohurisë për autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (ARRU)

4.19. Komentet e konsumatorëve mbi shërbimet e ofruara nga K.R.U. Gjakova Sh.A.

